

VENDIM
Nr. 22/2022

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
NGA TRUPA E PEDAGOGËVE TË FAKULTETEVE TË DREJTËSISË
DHE TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, SIPAS LIGJIT NR. 115/2016,
“PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”

Në mbështetje të nenit 147, pika 8, të Kushtetutës dhe nenit 35, pika 16, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të konsiderojë të zgjedhur kandidatët e listës së tretë për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor që ka rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Trupa e Pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës për shkak të mosarritjes së shumicës prej dy të tretave të votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit si më poshtë:

1. Yllka Rupa

2. Ilir Rusi

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar më datë 24.2.2022.